



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2019:135949

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519655

**Ac.nr.9478/2021**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu - kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Ylber Shurdhqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” p.n., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Kompania “..” Sh.P.K, me seli në F.K., kundër të paditurit R.P nga P...., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm, av. Qëndrim Krasniqi nga Prizreni, me objekt të padisë rimbursimin e dëmit (regresin), vlera e kontestit 3,623.00 €, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të pakohshëm të të paditurit e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1435/2015, i datës 08.06.2021, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Aprovohet ankesa e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit: R.P nga P....., PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C, C.nr.1435/2015, i datës 08.06.2021, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, , C.nr.1435/2015, i datës 08.06.2021, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i padituri R.P nga P...., që t’ia rimbursoj paditësit dëmin, në emër të borxhit në shumën prej 3,623.00, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e parashtrimit të padisë (30.12.2015) e deri në ditën e pagesës definitive të

mjeteve, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e të paditurit si të bazuar dhe të prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën me të gjitha shkresat ta kthej në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë 30.12.2015, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e bazuar, të detyrohet i padituri që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 3,623.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.08.2012 në Prizren, me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe t'i paguaj edhe shpenzimet gjyqësore të cilat do t'i caktoj kjo gjykatë, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar seancat e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1435/2015, i datës 08.06.2021, me të cilin e ka aprovuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyqimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: Së këndejmi, duke pasur parasysh të gjitha këto prova të administruara si dhe fakte të vërtetuara, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet se nuk ishte kontestuese se i padituri R.P nga P...., më datë 12.08.2012 rreth orës 13:45, me automjetin e tij BMW, me targa të regjistrimit 04-523-AA, ka shkaktuar aksident trafiku, në hyrje të lagjes "D.C" në Prizren, me ç'rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku, ka ndërruar shiritin e lëvizjes në mënyrë të pasigurt dhe kështu automjeti i të dëmtuarit Kastriot Kqira ka pësuar dëme materiale.

I padituri Ramadan Ponik si fajtor i aksidentit, i cili ka qenë duke e ngarë automjetin e siguruar tek KS “Illyria”, respektivisht i padituri ka qenë duke e ngarë automjetin që i ka skaduar mbulesa e sigurimit, pas periudhës kohore për të cilën ka pasur sigurim, kështu që bazuar në Ligjin për Sigurimin të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, personi i tretë - i dëmtuari Kastriot Kqira, ka pasur të drejtë në kompensimin e dëmit. Përmes ujdisë jashtë gjyqësore, Byroja Kosovare e Sigurimit në emër të kompensimit të të gjitha formave të dëmit material, ia ka kompensuar të dëmtuarit shumën e përgjithshme prej 3,623.00 euro. Përbushësi i detyrimit ndaj palës së tretë në emër të të siguarit, që nuk ka pasur mbulesë siguroese ka të drejtë të kërkoj rimbursimin e dëmit të paguar, që në këtë rast është Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS).

Tutje gjykata ka shtuar se bazuar në këto fakte, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri është i obliguar që paditësit në emër të rimbursimit të dëmit të paguajë shumën prej 3,623.00 euro, sepse me nenin 14 par. 1 pika 1.2. të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, parashihet që i siguruari mund të humbet mbulesën siguroese në rastet kur : *“Drejtuuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimin”*. Pastaj, me par. 2 të këtij neni është paraparë *“Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohet me dispozitat e paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim”*. Ndërsa me par. 3 të nenit 14 të ligjit të lartcekur është paraparë se *“Siguruesi pas përbushjes së detyrimit nga ky nen, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese”*. Gjithashtu me nenin 960 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet që: *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*. Andaj mbi këtë bazë ligjore, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejte dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), nenit 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 dhe nenit 79, 81, 82 dhe 83 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimi apo aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe

5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Po që se i referohemi arsyetimit të aktgjyqimit të atakuar, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, konstatohet se gjykata e shkallës së parë i është referuar vetëm deklaramentit të palëve-gjegjësisht të autorizuarve të tyre gjatë shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, të cilat i ka nxjerrë gjatë shqyrtimit kryesor, pa dhënë asnjë arsyetim të qartë dhe konciz lidhur me kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, arsye këto të cilat domosdoshmërisht çdoherë duhet ti përmbajë çdo vendim gjyqësor, lidhur me një çështje të caktuar.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 79, 81, 82 dhe 83, qëndron për faktin se gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me këto dispozita ligjore, ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurën. Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartë cekura, për arsyeje se, gjykata nuk ka respektuar kushtet ligjore të cilat duhet plotësuar për tu konsideruar i vlefshëm caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm, për arsyeje se në këtë rast nuk është bërë deponimi i shpenzimeve për pagimin e shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm, shpallja për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurën nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe nuk është afishuar në Tabelën e Shpalljeve të asaj gjykate, aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nuk iu është dërguar Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, çka do të thotë se përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurën është caktuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu gjatë shqyrtimit kryesor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar se konkretisht çfarë dëmi i është shkaktuar.

Në raport me të drejtën materiale gjykata i referohet gabimisht nenin 14 par. 1 pika 1.2. të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, pasi në këtë rast nuk kërkohet rimbursimin për shkakun se i padituri nuk ka pasur leje të vlefshme dhe adekuate për drejtimin e mjetit motorik, pasi i njëjti siç vërtetohet nga raporti policor ka pasur patentë shofer, por në këtë rast padia për rimbursimin dëmi është për shkak se pretendohet se i paditur nuk ka pasur mbulesë

siguruese gjegjësisht i ka skaduar sigurimi në kohën e shkaktimit të aksidentit, pra në rastin konkret është dallim esencial në raste kur e humb mbulesën sigurore me rastet kur nuk ka fare mbulesë sigurore, që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë e ngatërruar këtë çështje.

Si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri tek aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, me çka në këtë rast gjykata ankimore edhe përkundër faktit se ka pasur në konsideratë dhe parasysh se kemi të bëjmë me një lëndë të vjetër, konstatoi se nuk ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet apo vërtetohet, me çka nga një rrethanë e tillë aktgjykimi i atakuar u dashtë që të priset dhe lënda në fjalë, ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin, dhe pas kësaj gjykata të ndërmerri hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, që pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditëses. Me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lart nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.9478/2021 me datë 28.03.2024**

**Kryetari i kolegjit**  
Adnan Konushevc, d.v